



01Nr. 104/02-19584 /24

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit 04/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 8.7, të Rregullores me nr. 06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, si dhe rekomandimit të Komisionit vlerësues, Kryetari i Komunës me datë 15.08.2024 merr këtë :

VENDIM PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE

I. Me këtë vendim iu ndahen subvencione përfitueseve në bazë të thirrjes publike në programin "Subvencionimi i bizneseve ekzistuese mikro dhe të vogla" me Nr.10-104/02-15279 të datës 02.07.2024, sipas rekomandimit nga Komisioni vlerësues për ndarjen e subvencioneve në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit me Nr. 10-104/02-18047/24 i datës 01.08.2024.

II. Përfituesit si në pikën I të këtij vendimi janë:

1. Ardit Bela B.I. - (Autolarje te Blini) ;
2. Arditë Shehu - (OXFORD Education Center SH.P.K) ;
3. Astrit K. Dema B.I. - (Autolarje Pastrimi kimik Niti) ;
4. Bardhyl Kyqyku - (Kompakt Tech SH.P.K) ;
5. Euron Livoreka - (Euro Consulting SH.P.K) ;
6. Fatime Burrniku B.I. - (Rrobaqepëse FATEX) ;
7. Isuf Selimi B.I - (D.P.Z "PIRELLI 2000") ;
8. Jehona Dullovi - (Academy&Studio Jehona SH.P.K) ;
9. Kymete Burrniku B.I - (N.T.P. "Bleroni") ;
10. Lulzim Axhami B.I - (D.P.Z "Te Tafa") ;
11. Miranda Sallahi B.I. - (Miranda Lashes) ;
12. Selvije M. Krasniqi B.I - (Furra Diana) .
13. Tahir Zharku - (Kompania Aroma 05 SH.P.K) ;
14. Valon E. Berisha B.I -(Frizer Valoni) ;
15. Zejnepe Doda B.I - (P.P.Z "Eleganca") ;

III. Shuma totale e mjeteve financiare për subvencionim të përfituesëve të lartcekur është 30,477.70 €.

IV. Pagesat për përfituesit do të kryhen nga Kodi Ekonomik - Subvencione dhe Transfere -nënprogrami 48028, Planifikimi i Zhvillimit Ekonomik.

V. Marrëveshjet individuale me përfituesit do të lidhen konform dispozitave ligjore neni 13 , Rregullorja Nr.06/2016, nga Kryetari i Komunës duke u bazuar në këtë vendim si dhe në kompetencat ligjore që ka.

A r s y e t i m

Më datë 01.08.2024, Komisioni për ndarjen e subvencioneve në DZHET ka bërë Rekomandim me Nr.10-104/02-18047/24 për ndarjen e subvencioneve për 15 (pesëmbëdhjetë) aplikantë fitues dhe ka refuzuar 2 (dy) nga aplikacionet. Duke respektuar afatin e ankesave gjatë të cilit Komisioni kompetent ka pranuar dhe shqyrtuar brenda afatit ligjor me kompetencë ankesën e pranuar ku e njëjta sipas dispozitave ligjore në fuqi është refuzuar me vendim .

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

